



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr 73 dt.20.07.2001

PER
MIRATIM FONDI PER REHABILITIMIN E STADIUMIT "SELMAN
STERMASI"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 "Për buxhetin lokal" dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2001", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.43 dt.27.04.2001, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë reabilitimin e stadiumit "Selman Stërmasit" në masën prej 7.270.000 lekësh
2. Fondi prej 6.070 mijë lekësh do të kalojë në Ndërmarrjen Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit për:
 - a) Rikonstrukcion i rrjetit elektrik Rr. Muhamet Gjollësja dhe Rr. Gjin Bue Shpata **950 mijë lekë**
 - b) Ndriçimi elektrik i stadiumit "Selman Stërmasi" **566 mijë lekë**
 - c) Pajisje për sinjalistikën rrugore të stadiumit "S. Stërmasi" **126 mijë lekë**
 - d) Ndërtimin dhe sistemin para stadiumit "S. Stërmasi" **4428 mijë lekë**
3. Shuma prej 7.270 mijë lekësh të përballohet nga zëri "blerje pajisjesh" miratuar për Ndërmarrjen Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit

4. Ngarkohet Ndërmarrja Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Klubi i Futbollit Tirana të kryejnë të gjitha procedurat konform ligjit
5. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

